

**MIRATOHET:  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Elton KACIDHJA**

**Termat e Përgjithshme të referencës për studim projektim në rrjetin hidrik të qytetit të Tiranës në Njesitë 1,2,3,4,5 dhe Drejtorite Rajonale.**

Gjatë hartimit të projekteve të infrastruktures hidrike, të mbahen parasysh *Studimi i Materplanit të furnizimit me ujë dhe Kanalizime të realizuar nga BWP* (Studim i Masterplanit Afatmesëm të Zhvillimit Teknik dhe Strategjik të Ujësjetësimit dhe Kanalizimeve të Tiranës, (Budapest Waterworks + Lorenzo & Co) , parashikimet e *Plan Biznesit 2023-2027*.

Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara, duhet patur parasysh koeficienti i dendësisë së popullsisë, sipas *Rregullores së Furnizimit me ujë dhe kanalizime* në fuqi 150 l/sek për banorë , si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në perspektivë të zonave të ndryshme të Tiranës.

**1. Infrastruktura e rrjetit Ujësjetësimit**

Për trajtimin e rrjetit të Ujësjetësimit , rrjetit të transmetimit, rrjetit kryesor, dytesor dhe terciar , duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi ( **Vendimin Nr.83 datë 10.02.2021 Rregullat për projektimin dhe zbatimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve**)

Materialet, që do të përdoren, duhet të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrjetit hidrik.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

***Gjatë hartimit të projekteve do të merret në konsideratë duke bërë analizat e nevojshme dhe propozimet e nevojshme teknike sipas rregullores në fuqi të:***

- a) *Skema e rrjetit ekzistues të Ujësjetësimit*
- b) *Stacionet e Pompimit*
- c) *Impiantit të trajtimit të ujit*
- d) *Depot akumuluese në qytetin e Tiranës*

Te kihet parasysh të dhënat sa më poshte:

-Ujësjetësi i Selitës me prurje  $Q_{max} = 900$  l/sek dhe prurje  $Q_{min} = 230$  l/sek me gjatësi tuneli 6.5 km dhe dy tubacione çeliku  $\varnothing 600$  mm me gjatësi secila nga 3300 m.

-Ujësjetësi Shënmërisë, sot furnizohet me prurje  $Q_{min} = 500$  l/sek,  $Q_{max} = 640$  l/sek me tubacion çeliku  $\varnothing 700$  mm me gjatësi 16 km me ngritje mekanike nëpërmjet STP Qaf-Molle me 7 elektropompa me prurje  $Q = 100$  l/sek, H-210 m dhe N-440 kW.

-Ndërtimi i impjantit të trajtimit të ujit si fazë e parë është realizuar për një prurje prej 1800 l/sek. Kjo sasi uji realizohet nëpërmjet një linje transmetimi Ø 900 mm çelik me gjatësi 10 km e ndërtuar gjatë viteve 1996 – 1998. Në shtesën e re të investimit të impjantit prej 600 l/sek e ndërtuar në vitin 2020 U realizua investimi i një linje të re Ø 1200m/m gizë sferoidale L=360 m dhe tubacion Ø 900 m/m gsferoidale me gjatësi L= 9740m

Rrjeti hidrik I Ujesjellesit dhe Kanalizimeve trajtohen të tilla, që të sigurojnë garanci, qendrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës. Projektuesit e vleresoje shkallen e demtimit të ketyre rrjeteve dhe shtresat e nevojshme të rrugeve në të cilët këto linja kalojnë për rikthim në gjendje optimale. Në pjesët e të caktuara të parashikohet sistemimi i tyre.

Në vitin 2021 është hartuar master plani I furnizimit me ujë të Tiranës me prespektivë 25 vjeçare.

Në mbështetje të master planit është hartuar projekti preventive i zbatimit të rrjetit të ujësjellësit të presionit të lartë (ringut).

Ky projekt parashikon furnizimin me ujë të Tiranës me dy pika furnizimi. Depot e ujit në impjantin e trajtimit të ujit Bovillë me kapacitet  $V= 60000 \text{ m}^3$ . Është parashikuar një prurje maksimale 3600 l/sek në periudhën e thate dhe minimale 2000 l/sek në periudhën e lagët dhe në depot e Partitarit të sigurohet një prurje maksimale në periudhën e lagët prej 2500l/sek dhe periudhën e thatë prej 540 l/sek.

Në këte kuader me qëllim furnizimin me ujë 24-h u mendua studim projektimi në rrjetin hidrik të qytetit të Tiranës në Njesitë 1,2,3,4,5 dhe Drejtorite Rajonale.

Materialet, që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të ujesjelles - kanalizimeve.

Në bashkëpunim me Zyren e Azhornimit në UKT sh.a do të saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues, projektet, që ka kjo ndërmarje, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin ekzistues të ujësjellësit. Norma e furnizimit e rekomanduar do të jetë 150 l/ditë/banor.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

- a) Të bëjë relievin (azhornimin) e rrjetit; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
- b) Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës,
- c) Projektuesi duhet të bëjë verifikim paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë, që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra, që nuk përputhen me gjendjen në terren.

## **2. Infrastruktura e rrjetit të Kanalizimeve**

Për trajtimin e rrjetit të Kanalizimeve , kesoneve , rrjetit të kanalizimeve dhe pikave të shkarkimit duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi ( **Vendimin Nr.83 date 10.02.2021 Rregullat për projektimin dhe zbatimin e rrjetit të furnizimit dhe kanalizimeve**)

Materialet, që do të përdoren, duhet të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrjeteve hidrike.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

Rrjeti i kanalizimeve në qytetin e Tiranës ka një gjatësi rreth 650 km Km dhe është i sistemit mix ne 90% të tij. Ky rrjet punon me vetrjedhje deri në pikat përfundimtare të shkarkimit. Rrjeti i Kanalizimeve ndahet në kryesor 30%, sekondar 50% dhe tercial 20%. Për qytetin e Tiranës , me rreth 780.000 banore , dy jane pikat përfundimtare të shkarkimit:

- Lumi i Lanes
- Lumi i Tiranës

Shkarkimi i ujrave mix në Lumin e Lanes ose në Lumin e Tiranës, në pjese të ndryshme të gjatësisë së tij bëhet nëpërmjet **kolektoreve pritës të** qytetit ose nëpërmjet **përrenjve**, të cilët kalojnë në zona të banuara të qytetit. Në këto zona përrenjtë janë të mbyllur me tubacione betoni 2x 1000mm, 2x 1500mm 2x2000mm.

Aktualisht shkarkimet e ujërave të ndotura në Perrenj ose Lumenj , bëhen drej perdrejt, pa bërë trajtimin e tyre.

Rrjeti i kanalizimeve përbëhet nga tubacione me diameter nga 200mm deri ne 2000mm, materiali i tubacioneve është beton, beton/a, dhe PE i brinjezuar.

Në përbërje e tij, rrjeti i kanalizimeve ka edhe pusetat e kontrollit si element bazë për kontrollin dhe mirmbajtjen e tij.

Një pjesë e mire e kolektorëve kryesorë të qytetit janë ndërtuar sipas studimit dhe projektit të zbatimit të hartuar në vitin 1962 për një periudhë 20 vjeçare dhe për një numur popullsie prej 200-250 mijë banore.

Në vitet më pas deri ne vitin 1997, nuk është bërë asnjë studim për kolektorët kryesorë, por vetem i zonave të ndryshme te qytetit , te pakanalizuara, me grykderdhje pikerisht ne keta kolektore.

Ne vitin 1997 Shoqeria JICA, paraqiti raportin final te studimit te rrjetit te kanalizimeve ne qytetin e Tiranës I cili u nderpre dhe ne qershor te vitit 2014ka filluar implementimi i tij, i cili merr në konsideratë :

1. Kolektorin e Bulevardit „Bajram Curri“( me mikro tunel H=-8m)
2. Ndërtimin e kolektorit nga Shkolla Teknologjike deri ne impjantin e pastrimit Kashar (mikro tunel H= -18m)
3. Ndërtimi i Impjantit të Pastrimit në Kashar (i cili ka filluar punimet në qershor 2014)

***Gjate hartimit te projekteve do te meret ne konsiderate duke bere analizat e nevojshme dhe propozimet e nevojshme teknike sipas rregulloreve ne fuqi te:***

***e) Skema e rrjetit ekzistues te kanalizimeve***

Rrjeti hidrik I Ujesjellesit dhe Kanalizimeve trajtohen të tilla, që të sigurojnë garanci, qendrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës. Projektuesit e vleresoje shkallen e demtimit te ketyre rrjeteve dhe shtresat e nevojshme te rrugeve ne te cilet keto linja kalojne per rikthim ne gjendje optimale. Në pjesët e te caktuara të parashikohet sistemimi i tyre.

Materialet, që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të ujesjelles - kanalizimeve.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

- a) Të bëjë relievin (azhornimin) e rrjetit; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
- b) Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës,
- c) Projektuesi duhet të bëjë verifikim paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë, që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra, që nuk përputhen me gjendjen në terren.

Per llogaritjen e sistemit të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe të furnizimi me uje, të merret në konsideratë perspektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë.

Të merret në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcjellës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar duhet të merret pranë Sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.

Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës do të merret në Bashki.

Të merret në konsideratë “**Studimi i Planit të zhvillimit të sistemit të kanalizimeve**” kryer nga firma “JICA” dhe studimet pjesore të miratuara në zonën në fjalë.

### **3. Hidrantët zjarrfikës**

Duhet të parashikohen hidrantet zjarrfikës, që të bëhet i mundur lehtësimi i punës gjatë veprimtarisë operationale për shuarjen e zjarreve, referuar normave të miratuara në fuqi dhe rregullores së PMNZSH-së.

#### **Veprat e Artit (mure mbajtes, mure prites, tombino, ura etj.)**

Strukturat shtese te cilat shoqerohen me tubacionet ne trupin e rruges sic jane mure mbajtes, mure prites, tombino, e keshtu me radhe, mundesojne mbajtjen dhe sigurine e trupit te rruges, kalimin e pengesave sic jane rrugët, perrenjt etj.

Per te gjithë karakteristikat teknike te realizimit te tyre si dhe rrugeve perkatese te intersektuara duhet ti referohemi Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 15.7.2015

Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrjetit të Furnizimit me uje dhe Kanalizime

#### **Standartet**

##### **a) Standarte në projektim**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira kombetare dhe ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

#### ***b) Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik***

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon **VKM 379 date 25.05.2016**.

### **11. Realizimi i projektit**

**Realizimi i projektit te infrastruktures rrugore do të mbështetet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, nenit 37, të VKM.354, dt 11.05.2016 “Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit” sipas fazave të mëposhtme:**

FAZA I- Analiza e detyrës së projektimit/termat e references dhe përcaktimi i bazës sëprojektit

FAZA II- Projekt-idenë paraprake

FAZA III- Projekt-ideja përfundimtare

FAZA IV - Projektet për miratimin e lejes

ndertimi

FAZA V- Projektet e zbatimit

FAZA VI - Preventivat përfundimtar

FAZA VII - Përgatitja e dokumentacionit për procedure ne tenderimit

Neni 37:Shërbimet për planifikimin e objekteve ndërtimore inxhinierike dhe të komunikacionit

Detyrat e detajuara sipas fazave:

*1-FAZA I- Analiza e detyrës së projektimit/termat e references dhe përcaktimi i bazës së projektit*

Shërbime bazë

- a) Sqarimi i shtrimit të detyrës për zonën e planifikimit
- b) Vrojtimi i vendit
- c) Përmbledhja e qëllimeve të planifikimit që influencojnë për detyrën
- d) Përmbledhja e dokumentave të vlefshme për kryerjen e shërbimit.
- e) Shpjegimi i të dhënave të planit
- f) Llogaritja e vëllimit të punës dhe punimeve paraprake të nevojshme, p.sh. studime të tabanit të ndërtimit, punime matjeje, mbrotja nga erozionet;
- g) Formulimi i ndihmave për vendimin për zgjedhjen e pjesëmarrëve të tjerë, që marrin pjesë profesionalist në planifikim.
- h) Përmbledhja e rezultateve.
  - i. Shërbimet e veçanta
    - a) Zgjedhja dhe vrojtimi i objekteve të ngjashme
    - b) Llogaritja e ngarkesave të veçanta, që nuk janë përcaktuar në normë

## *2-FAZA II- Projekt-idenë paraprake (përgatitja e projektit dhe planifikimit)*

Përpunimi i pjesëve të rëndësishme të një zgjidhje të detyrës së planifikimit

- i. Shërbime bazë
  - a) Akordimi i qëllimeve të përfytyruara me kushtet anësore, të cilat jepen veçanërisht nga rregullimi i territorit, planifikimi i ndërtimit, Planifikimi i detajuar vendor si dhe nga planifikimit vendore dhe kombëtare.
  - b) Studimi i mundësive të zgjidhjes me influencat mbi kompozimin ndërtimor dhe konstruktiv, përshtatshmërinë, rentabilitetin duke respektuar pajtueshmërinë me mjedisin, sigurimi dhe vlerësimi i hartave zyrtare.
  - c) Përpunimi i një koncepti planifikimi, përfshirë studimin zgjidhjeve të mundshme alternative me kërkesa të njejta me paraqitje vizimore dhe vlerësim duke përpunuar kontribute të pjesëmarrësve të tjerë që marrin pjesë profesionalisht në planifikim.
  - d) Sqarimi dhe shpjegimi i lidhjeve themelore specifike të specialistit, procese dhe kushte.
  - e) Bisedime paraprake me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim, në rast se duhet për pagesë (sponsorizim) dhe pjesëmarrje në shpenzime.
  - f) Bashkëveprim në shpjegimin e konceptit të planifikimit kundrejt qytetarëve dhe organeve politike
  - g) Përpunimi i konceptit të planifikimit sipas vërejtjeve dhe propozimeve
  - h) Përgatitja e dokumentave si ekstrakte nga projektideja paraprake për përdorim për një procedurë të rregullimit të territorit
  - i) Vlerësimi i shpenzimeve (preventivi)
  - j) Përmbledhja e të gjitha rezultateve të planifikimit paraprak

## *3-FAZA III-Projekt-ideja përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)*

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së projektimit dhe termave të referencës.

i. Shërbime bazë

- a) Përpunimi i konceptit të planifikimit (përpunimi hap pas hapi i një zgjidhjeje vizatimore) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në projektidenë e plotë.
- b) Raport shpjegues.
- c) Llogaritje specifike të fushës, përjashtoj llogaritjet e strukturës mbajtëse.
- ç) Paraqitje vizatimore e të gjithë projektidesë.
- d) Plani i financimit, plani i kohëve të ndërtimit dhe i shpenzimeve. Llogaritja dhe argumentimi i shpenzimeve që mund të sigurohen me ndihmë (subvencionim) si dhe përgatitja e kërkesave për financim; bashkëpunim gjatë shpjegimit të projektidesë paraprake ndaj qytetarëve dhe organeve publike; Përpunimi i projektidesë sipas vërejtjeve dhe propozimeve.
- dh) Bisedime me autoritete dhe pjesëmarrës të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, për aftësinë për miratim.
- e) Llogaritja e shpenzimeve
- ë) Kontrolli i shpenzimeve duke krahasuar llogaritjen e shpenzimeve me vlerësimin e shpenzimeve
- g) Përmbledhja e të gjitha dokumenteve të projektidesë.

ii. Shërbimet e veçanta

- a) Sigurimi i ekstrakteve nga libri themeltar, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe dokumente të tjera zyrtare
- b) Vazhdimi i studimeve dobi-shpenzime
- ç) Bashkëveprim gjatë marrëveshjeve administrative

#### *4-FAZA IV-Projektet për miratimin e lejes së ndërtimit*

Përpunimi dhe dorëzimi i dokumenteve për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

i. Shërbimet bazë

- a) Përpunimi i dokumenteve e nevojshme për procedurat publike e ligjore përfshirë kërkesat për raste përjashtimore dhe lirime (nga detyrime), përmbledhja e dokumentacionit të veprës ndërtimore dhe përdorimi i kontributeve të pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim
- b) Dorëzimi i dokumenteve
- c) Plani për blerjen e truallit dhe dokumentet për blerjen e truallit nese ka nevojë.

- d) Plotësimi dhe përshtatja e dokumenteve të planifikimit, përshkrime dhe llogaritje duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim
- dh) Bashkëpunim gjatë shpjegimeve ndaj qytetarëve
- d) Bashkëpunim në procedurën e miratimit të planit përfshirë pjesëmarrjen në takime shqyrtimi si dhe bashkëpunim në hartimin e qëndrimit ndaj vërejtjeve dhe propozimeve.

ii. Shërbimet e veçanta

- a) Bashkëpunim në sigurimin e aprovimit të të prekurve

*5-FAZA V- Projekti i zbatimit*

Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

i. Shërbimet bazë

- a) Përpunimi i rezultateve të fazave të punimeve 3 dhe 4 (përgatitja hap pas hapi e zgjidhjes dhe e paraqitjes së saj) duke pasur parasysh të gjitha kërkesat specifike të fushës dhe duke përdorur kontributet e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, deri në zgjidhjen e aftë për zbatim.
- b) Paraqitje vizatimore dhe llogaritëse e objektit me të gjitha të dhënat e veçanta të nevojshme për zbatimin, përfshirë vizatime të detajuara në shkallët e kërkuara.
- c) Përpunimi i bazave për të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim, dhe integrimi i kontributeve të tyre deri në zgjidhjen e aftë për zbatim
- ç) Vazhdimi i planifikimit të zbatimit gjatë ndërtimit të objektit

ii. Shërbimet e veçanta

- d) Hartimi grafikut të punimeve dhe i planeve të rrjetit të infrastrukturës

*6-FAZA VI-Preventivat përfundimtar*

Llogaritja e sasive, përgatitja e analizave të çmimeve dhe hartimi i dokumentave të tenderit.

i. Shërbimet bazë:

- a) Llogaritja e sasive dhe renditja e pozicioneve të veçanta duke përfshirë kontributin e pjesëmarrësve të tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;
- b) Hartimi i dokumenteve të dhënies, në mënyrë të veçantë i përshkrimeve të punëve me listën e punëve si dhe të kushteve të veçanta kontraktuale;
- c) Akordimi dhe koordinimi i dokumenteve të dhënies me pjesëmarrësit e tjerë, që marrin pjesë profesionalisht në planifikim;
- ç) Përcaktimi i fazave kryesore të zbatimit;

- d) Çmimet e preventivit të hartohet sipas VKM në fuqi ose me analize teknike kur zerat e punes nuk parashikohen ne VKM



## *7-FAZA VII- Përgatitja e dokumentacionit për procedurën e tenderimit*

Përgatitja e dokumentacionit tekniko –ligjor sipas kritereve të prokurimit

*Mjetet që do të ofrohen*

Bashkia Tirane, dhe UKT sh.a do të sigurojë mbështetje në të gjitha informacionet, hartat, studimet, modelet, dokumente ligjore përkatëse etj, pa asnjë kosto për Konsulentin. Bashkia Tirane dhe UKT sh.a do të ndihmojë Konsulentin për të marrë informacione, të dhëna dhe shërbime të tjera në zonën e projektit dhe në bashkëpunim me autoritetet apo institucionet për të cilat ka nevojë për leje apo autorizim.

Shërbimi do të ketë një kohëzgjatje të përgjithshme prej 6 muajsh për prezantimin e **Produktit Final** të projektimit, duke përfshirë të gjitha vizatimet e detajuara të projektimit, dokumentat dhe raportet, specifikimet etj.

***Të gjitha raportet dhe dokumentet e përgatitura në bazë të këtij projekti do të jetë në gjuhën shqipe dhe tre kopje në gjuhën angleze***, ne jo me pak se 3-kopje ne PDF dhe DWG si dhe ne forme elektronike ne CD

Në përgjithësi, raportet e rezultateve do të shpërndahen së pari në draft -projekt, duke u diskutuar dhe duke u pajtuar me grupet e interesit, para finalizimit bazë të komenteve të marra.

**Rekomandojme që stafi të ketë profilin si më poshtë:**

***Projektues inxhinier hidroteknik***

**Ekspert në projektimin te furnizimit me uje**

***Projektues inxhinier konstruktor:***

**Ekspert në projektimin të strukturave beton-arme të qëndrueshme me/pa prani të ujit.**

***Projektues gjeodet/topgraf/markshajder:***

**Expert me njohuri të metodave moderne të studimit dhe prodhimin e hartës dixhitale në:**

- Bazamente gjeodezike
- Rivelime në të gjitha shkallët
- Projektim fotogrametrik
- Hartografike/Topografike
- Perdorim te sistemit GIS

***Projektues inxhinier mekanik***

Expert me njohuri të projektimit të sistemeve kundra zjarrit dhe të gjitha proceseve që përmbajne njohuri të fushës së mekanikës

***Projektues gjeollogo inxhinierik***

Expert me njohuri të projektimit të shpimeve për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objekteve inxhinierike dhe të furnizimit me ujë.

***Operatore të programit Autocad, watercad, Waterjems etj:***

Ekspert në prodhimin e vizatimeve CAD për planimetritë, marrëveshjet e përgjithëshme, vepra strukturore dhe elektro-mekanike.

***Operatore të sistemit GIS:***

Ekspert në prodhimin e hartave me planvendosjet me Sistem GIS për planimetritë e tubacioneve, vepra strukturore dhe elektro-mekanike

***Profili i ekspertëve duhet të bazohet në ligjin në fuqi si dhe kërkesat për pajisjen me lejet përkatëse.***